

MANUALI I PËRDORIMIT

Telekomanda


Magjike

Lexojeni me kujdes manualin përpara se të përdorni telekomandën dhe ruajeni për referencë në të ardhmen.


AN-MR650A

AKSESORËT

Figura e shfaqur e telekomandës mund të ndryshojë nga produkti aktual.
(Në varësi të shtetit)



Telekomanda magjike dhe bateritë alkaline (AA)




Manuali i përdorimit

- Përmbajtja e këtij manuali mund të ndryshohet pa njoftim paraprak për shkaqe përmirësimi të funksioneve të produktit.

BATERITË

1. Vendosja e baterive

- Lexoni me kujdes manualin.
- Shtypni pjesën e sipërme të kapakut të baterisë, rrëshqiteni për mbrapa dhe ngrijeni sipas ilustrimit më poshtë.
- Për të ndërruar bateritë, hapni kapakun e baterive, vendosni bateritë alkaline (1,5 V, AA) sipas skajeve $\oplus$ dhe $\ominus$ në etiketën brenda folesë dhe mbylleni kapakun. Sigurohuni ta drejtoni telekomandën drejt sensorit të telekomandës në televizor.
- Për të hequr bateritë, ndiqni hapat e instalimit anasjelltas. Mos përdorni bashkë bateri të vjetra me të reja. Mbylleni kapakun në mënyrë të sigurt.
- Hapeni kapakun e baterisë për të parë etiketën.




2. Masa paraprake

- Pas ndërrimit të baterisë, përdore telekomandën duke ndjekur procedurën e çiftimit sipas manualit të përdorimit.
- Nëse njësia nuk punon pas ndërrimit të baterisë, riprovo çiftimin sipas manualit të përdorimit.
- Nëse telekomanda nuk përdoret për periudha të gjata kohe, rekomandohet ta heqësh baterinë nga njësia.
- Mos e çmonto dhe mos e ekspozo baterinë ndaj nxehtësisë.
- Mos e rrëzo baterinë dhe mos ushtrto forcë të tepërt që mund të shkaktojë dëmtim të kapakut.
- Mos e zhyt baterinë në ujë.
- Ka rrezik shpërthimi nëse bateria nuk vendoset saktë.
- Hidhi siç duhet bateritë e përdorura.

PËRSHKRIMI I TELEKOMANDËS

- Figura e shfaqur e telekomandës mund të ndryshojë nga produkti aktual.
- Renditja e përshkrimit mund të ndryshojë nga produkti konkret.
- Disa butona dhe shërbime mund të mos jenë në dispozicion në varësi të modeleve ose të rajoneve.



(ENERGJIA)

Fik ose ndez televizorin.

STB PWR / 機上盒電源

Dekoderin mund ta ndezësh apo fikësh duke e shtuar në telekomandën universale të televizorit.

Butonat me numra

Vendos numra.

Butonat me shkronja

Vendos shkronja.

(Hapësisë)

Krijon një hapësisë bosh në tastierën në ekran.

(VIZË)

Vendos një  (VIZË) midis numrave, si p.sh. 2-1 dhe 2-2.

LIST / 節目列表

Hap listën e kanaleve ose të programeve të ruajtura.

DATA*

Shtyp këtë buton për të hapur transmetimin e të dhënave "BML".

QUICK ACCESS*/ 智慧快選*

Mund të hapni aplikacione ose Live TV duke përdorur butonat me numra që i korrespondojnë funksioneve.

(Telekomanda virtuale)

Shfaq telekomandën virtuale.

- Hyn në menunë e telekomandës universale në disa rajone.

AD*/SAP*

Aktivizohet funksioni i përshkrimeve të figurës/zërit.

* Funksioni SAP (Secondary Audio Program - programi i zërit dytësor) mund të aktivizohet edhe me shtypjen e butonit **SAP***. (Vlen për Amerikën e Veriut)

+ VOL / / 音量 -

Rregullon nivelin e volumnit.

(PA ZË)


Hesht të gjithë tingujt.



Hyn në menunë Aksesibiliteti.

CH / P / 頻道

Lëviz nëpër kanalet ose programet e ruajtura.



(Njohja e zërit)

Nevojitet lidhja në rrjet për të përdorur funksionin e njohjes së zërit.

1. Shtyp butonin e njohjes së zërit.
2. Fol pasi të shfaqet dritarja e ekranit të zërit në ekranin e televizorit

(KËRKIMI)*

Kërko materiale, si p.sh. programe televizive, filma dhe video të tjera ose kryej kërkim në internet duke dhënë termat për kërkim në fushën e kërkimit.

(FAQJA KRYESORE)

Hyn në menynë kryesore.

RECENTS* / 最近紀錄*

Tregon historikun e mëparshëm.

STB MENU

Shfaq menynë kryesore të dekoderit. (Kur nuk shikon me dekoder : ekrani kalon në pamjen nga dekoderi.)

Rrota (OK)

Shtyp mesin e butonit  Rrota (OK) për të zgjedhur një menu.

Kanalet ose programet mund t'i ndryshosh duke përdorur butonin  Rrota (OK).

(lart/poshtë/majtas/djathtas)

Shtyp butonin lart, poshtë, majtas ose djathtas për të lëvizur nëpër menu.

Nëse shtyp butonat   kur përdoret treguesi, ky do të zhduket nga ekrani dhe telekomanda magjike punon si telekomandë e zakonshme.


Për ta shfaqur sërish treguesin në ekran, tunde telekomandën magjike majtas dhe djathtas.

BACK / 退回

Kthehet në ekranin e mëparshëm.

EXIT* / 離開*

Pastron pamjet në ekran dhe kthehet në shikimin e Hyrjes së fundit.



GUIDE / 節目導覽

Tregon guidën e kanaleve ose të programeve.

CAPTION

Aktivizon ose çaktivizon titrat.

☞ (HYRJA)

Ndryshon burimin e hyrjes.

* Shtypja dhe mbajtja e butonit ☞ (Hyrje) shfaq të gjitha listat e hyrjeve të jashtme.

Butonat e shërbimeve të transmetimit

Lidhet me shërbimin e videotransmetimit.

⚙️ (Cilësimet e shpejta)

Hyn në Cilësimet e shpejta.

* Shtypja dhe mbajtja e butonit ⚙️ (Cilësimet) shfaq menyën Cilësimet e përparuara.

Butonat me ngjyra

Këta bëjnë të mundur përdorimin e funksioneve të veçanta në disa menu.

Butonat e komandimit (▶, ||)

Kontrollon materialet multimedia.

TEXT / T.OPT (Butonat e TELETEKSTIT)

Këta butona përdoren për teletekstin.

MAGIC LINK* / 智慧提示*

Ofron përmbajtje në lidhje me programin që po shikon aktualisht.

LIVE ZOOM / 即時縮放

Duke zmadhuar zonën e zgjedhur, mund ta shfaqësh në pamje ekrani të plotë.


FOCUS* / 畫面放大*

Mund të zmadhosh zonën nga e cila është drejtuar telekomanda.

* Për të përdorur butonin, shtyp dhe mbaj shtypur për më shumë se 3 sekonda.

PËRDORIMI


1. Regjistrimi dhe çregjistrimi



Regjistrimi i telekomandës magjike

Për të përdorur telekomandën magjike, fillimisht çiftoje me televizorin.

1. Vendosi bateritë në telekomandën magjike dhe ndiz televizorin.
 2. Drejtoje telekomandën magjike nga televizori dhe shtyp **Rrota (OK)** në telekomandë.
- Nëse televizori nuk arrin të regjistrojë telekomandën magjike, provo sërish pasi ta fikësh dhe rindezësh televizorin.





Çregjistrimi i telekomandës magjike

Shtyp njëkohësisht butonat **FAQJA KRYESORE** dhe **BACK / 返回** për pesë sekonda, për të shkëputur çiftimin e telekomandës magjike me televizorin.

- Shtypja dhe mbajtja e butonit **GUIDE / 節目導覽** mundëson anulimin dhe reregjistrimin e menjëhershëm të telekomandës magjike. (Në disa modele televizorësh, duhet përdorur butoni **CAPTION**.)

2. Përdorimi



- Tund lehtë telekomandën magjike majtas-djathtas ose shtyp butonat 🏠 (FAQJA KRYESORE), 📶 (HYRJA), ⚙️ (Cilësimet e shpejta) për ta shfaqur treguesin në ekran.
(Në disa modele televizorësh, treguesi do të shfaqet kur të rrotullosh butonin ⏸️ Rrota (OK).)
- Nëse treguesi nuk është përdorur për një farë kohe ose nëse telekomanda magjike vendoset mbi një sipërfaqe të sheshtë, treguesi do të zhduket.
- Nëse treguesi nuk reagon mirë, mund ta rivendosësh duke e lëvizur në buzë të ekranit.
- Telekomanda magjike i shkarkon bateritë më shpejt sesa telekomandat normale për shkak të funksioneve shtesë.

MASAT PARAPRAKE

- Përdore telekomandën brenda rrezes së specifikuar (brenda 10 m).
Komunikimi mund të mos kryhet nëse pajisja përdoret jashtë zonës së mbulimit ose nëse ka pengesa brenda zonës.
- Mund të kesh probleme komunikimi në varësi të aksesorëve.
Pajisjet si furra me mikrovalë dhe LAN me valë punojnë në të njëjtin bandë frekuençe (2,4 GHz) me telekomandën magjike. Kjo mund të shkaktojë probleme komunikimi.
- Telekomanda magjike mund të mos punojë siç duhet nëse routeri me valë (pikëhyrja) është nën 1 metër nga televizori. Routeri me valë duhet të jetë më shumë se 1 metër larg televizorit.
- Mos e çmonto ose nxeh baterinë.
- Mos e rrëzo baterinë. Shmang goditjet e forta ndaj baterisë.
- Vendosja e baterisë në mënyrë të gabuar mund të shkaktojë shpërthim.

SPECIFIKIMET

KATEGORITË	TË DHËNAT
Nr. i modelit	AN-MR650A
Diapazoni i frekuencës	2,400 GHz deri në 2,4835 GHz
Fuqia në dalje (Maks.)	4 dBm
Kanali	40 kanale
Ndjeshmëria e sinjalit	-94,5 dBm
Përmasat (mm)	Gjerësia 48,3 x gjatësia 183,5 x trashësia 33,7 (tolerancë prej ± 1 mm)
Pesha	101,7 g $\pm$ 8 g (pa bateri)
Burimi i energjisë	AA 1,5 V, përdoren 2 bateri alkaline
Konsumi i energjisë	300 mW
Diapazoni i temperaturës së punës	0 °C deri në 40 °C

